

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTRI PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS - МИНИСТАРСТВО ЗА  
 КОСОВСКИЕ СНАГАНА БЕЗБЕДНОСТИ - MINISTRY OF KOSOVO SECURITY FORCE  
 ZYRA E SEKRETARITË PËRHERSHËM-KANCELARIA PERMANENTNOG  
 SEKRETARA-OFFICE OF THE PERMANENT SECRETARY

Nr. Prot: 230  
 Broj Prot: 230  
 Nr. i faqeve: 3  
 Broj. stranica: 3  
 Datum: 26.01.2018  
 Date: 26.01.2018  
 Prishtinë / a



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
 ZYRA E KRYEMINISTRIT - URBEDPREMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER  
 SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR

Nr. Prot: 288  
 Broj Prot: 288  
 Nr. i faqeve: -3-  
 Broj. stranica: -3-  
 Datum: 26.01.2018  
 Date: 26.01.2018  
 Prishtinë / a

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosova  
 Qeveria - Vlada - Government  
 MFSK/MKSF/MKBS

Komision për Hetimin e Aksidenteve  
 dhe Incidenteve Aeronautike

Bazuar në Rregulloren Nr. 11/2010-MFSK për Marrëveshjet me Organizatat Jo-Qeveritare dhe Institucionet Publike dhe Private dhe në Ligjin e Aviacionit nr.03/L-051 në nenin 31 paragrafi 31.6 lidhet:

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NË MES TË

MINISTRISË PËR FORCËN E SIGURISË SË KOSOVËS

DHE

KOMISIONI PËR HETIMIN E AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE  
 AERONAUTIKE

Prishtinë datë 23.01.2018

1. **Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës**, adresa Kazerma “Adem Jashari”- Prishtinë, të cilën e përfaqëson **Dr. Shkelzen Sylaj** – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe
2. **Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA)**, të cilën e përfaqëson z. **Mirsim Beqiri - Kryesues**

Në tekstin e mëtejme ‘‘Palët’’

### **Neni 1** **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja e MFSK/FSK – së,për Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike të Republikës së Kosovës, në rastet të ndonjë aksidenti ajror apo hekurudhor, në territorin e Republikës së Kosovës.

### **Neni 2** **Obligimet e Palëve**

1. Forca e Sigurisë së Kosovës, në rast të ndonjë aksidenti ajror apo hekurudhor, do ta mbështetë Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike, me njësitin e Kërkim Shpëtimit të FSK-së, me qëllim të gjetjes së personave të zhdukur dhe materialeve tjera, objekt i hetimeve dhe kërkimeve të Komisionit.

2. Forca e Sigurisë së Kosovës, do ta mbështet me transport Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike të Kosovës, në bartjen e mbetjeve të fluturakeve ajrore dhe atyre hekurudhore, nga vendi i aksidentit deri në lokacion e caktuar nga Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike

### **Neni 3** **Ekzekutimi**

1. Palët nënshkruese marrin përsipër që t’i përmbahen dispozitave të kësaj marrëveshje.

### **Neni 4** **Ndryshimet dhe Ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit**

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet, plotësohet apo ndërpritet vetëm me pëlqimin e palëve nënshkruese.

### **Neni 5** **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me marrëveshje dhe mirëkuptim mes Palëve.

**Neni 6**  
**Kopjet origjinale**

Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, në gjuhë shqipe, nga dy (2) kopje për secilën palë.

**Neni 7**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhe të caktuar, dhe vlen vetëm për përmbushjen e qëllimit që rrjedh nga kjo Marrëveshje.

**P A L Ë T N Ë N S H K R U E S E**

Për MFSK

Dr. Shkelzen Sylaj

Sekretar/Përgjithshëm



Për KHAIA

Z. Mirsim Beqiri

Kryesues

